

# STATUT

## i Shoqërisë "REFAB Construction" shpk

### KREU I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

##### NENI 1

###### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1) Sot më datë **01 Mars 2021**, unë themeluesi kam krijuar Shoqërinë me Përgjegjesi të Kufizuar me emrin **REFAB Construction shpk**.
- 2) Shoqëria është themeluar nga ortaku i vetem **Z. Festim Troci**, atësia **Muharrem** i dtl. 06/04/1979 lindur në **Draj**, Rec dhe banues në **Tiranë** identifikuar nga karta e identitetit me nr. 036409926, numer personal H90406075J, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- 3) Shoqëria **REFAB Construction shpk** është krijuar në përputhje me **Ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008, "Per Shoqëritë Tregtare"**, për të ushtruar veprimtari të përbashket sipas parashikimeve të bëra në këtë Statut.
- 4) Emërtimi i shoqërisë është **REFAB Construction shpk**. Shoqëria, e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti është krijuar me mjetet në pronësi private të themeluesit së saj.

##### NENI 2

###### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

###### **Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e mëposhtme:**

- 1) Ne fushen e ndertimit : Ndërtime civile, turistike industriale dhe natyrave te tjera, ndertim objektesh banimi dhe sherbimesh, ndertim objektesh publike e jopublike, ndertim objektesh turistike, ura, rruge, hekurudha. Montim konstruksionesh metalike, aktivitete te ndryshme ne fushen e ndertimit. si edhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimeve të biznesit e që nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.

##### NENI 3

###### Kohëzgjatja

- 2) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin pa afat të përcaktuar.

##### NENI 4

###### Selia e shoqërisë

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën **Tirane, Rruga Frederik Shiroka, Kulla Nr.3, Kati i pare, Dyqani 19**
- 2) Ajo mund të çelë filiale degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 1) Adresa e komunikimit elektronik(email) është: **info@refabconstruction.com**



## **KREU II** **Kapitali**

### **NENI 5** **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitalit themeltar i shoqërisë është **100.000,00 (njëqind mijë) lekë**.
- 2) Ortak i Vetëm i Shoqërisë është Z. Festim Troci me 100% të kapitalit të përbërë nga 1 (një) kuotë.
- 3) Ky kapital është i ndarë në 1(një) pjesë. Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi të marrin miratimin e ortakëve të tjerë të shoqërisë, duke respektuar të drejtën e parablerjes, kur transferimi behet me anë të shitjes.

### **NENI 6** **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të kapitalit për kontributet në para dhe me anë të kontributëve në natyrë, duke emëruar nga gjykata një Auditues ligjor për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqsojnë.

### **NENI 7** **Trasferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Dhurimit;
- d) Trashëgimnisë;
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimnie.

## **KREU III**





## Organet vendimore dhe drejtuese

### NENI 8

#### Asambleja e Përgjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ne mbledhjet e tyre përkatëse.

Ortakët lajmërohen me shkresë, të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

Njoftimi duhet të përmbajë: ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja; si dhe rendin e ditës.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose në mungesë të tij nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 % të kuotave të kapitalit themeltar nëpërmjet kërkesës me shkrim drejtuar administratorit.

Ne rast se Administratori refuzon apo nuk fillon procedurën për thirrjen e Asamblesë se Ortakëve, ortakët që kanë kërkuar mbajtjen e asamblesë, mund të bëjnë vete lajmërimin e ortakëve të tjerë, duke respektuar procedurat e parashikuara ne këtë nen.

Asambleja e Përgjithshme e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të marre vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marre vendime pavarësisht parregullsisë se njoftimit.

Asambleja e ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda tre muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore apo sipas rasteve të parashikuara ne ligj.

Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht ortakëve.

Në mbledhjet e Asamblesë vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligjin "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në rast se Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për:

- Ndryshimin e statutit;
- Zmadhimin, apo zvogëlimin e kapitalit;
- Të kaluar në likuidim të parakohshëm shoqërinë, ose për të zgjatur afatin.
- Shpërndarjen e fitimeve.

*Atëherë vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kuotave të kapitalit themeltar.*

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit themeltar që ai zotëron.

***Te drejtat e Asamblesë se Ortakëve do te ushtrohen nga Ortaku i Vetëm për aq kohë sa shoqëria do te jetë me një ortak..***



**NENI 9**  
**Kompetencat e Asamblesë**

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) Ndyshimin e statutit;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin e Likujdatorit dhe Audituesve Ligjorë;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët , Likujdatorin dhe Audituesve Ligjorë;
- e) Mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) Çështjet e tjera të parashikuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo statuti;

**NENI 10**  
**Përfshirja nga drejta e votës.**

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendime për:
  - a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) Ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
  - d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, përfaqësuesi vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ashtu si ortaku të cilin përfaqëson.

**NENI 11**  
**Administrimi i shoqërisë**

- 1) Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.
- 2) Administrator i parë i shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm i saj, **Z. Festim Troci**.
- 3) Afati i ushtrimit të detyrës nga administratori është për **5 vjet**.





- 4) Detyra e administratorit, nëpërmjet shkarkimit me vendim të ortakeve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesës së kapitalit themeltar, kur vetë administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.
- 5) Nga momenti i mbarimit të mandatit, shkarkimit, apo dorëheqjes administratori i vjetër do vazhdojë të përfaqësojë shoqërinë deri në emërimin e administratorit të ri, por pa patur të drejtë të kryejë veprime tregtare.

## NENI 12

### Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

- a) Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua kufizon atyre apo iu jep shprehimisht ortakëve;
- c) Të emërojë dhe të shkarkojë nga puna punëmarrësit e shoqërisë.
- d) Të japë urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe të vendosë sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
- e) Administratori duhet të drejtojë e të organizojë punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- f) Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- g) Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- h) T'i paraqesë në mënyrë të rregullt Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancit dhe llogaritë vjetore brenda një afati prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar;
- i) Administratori ka të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- j) Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit.
- k) Përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve administrative, gjyqësore ose të tretëve, e realizon administratori personalisht ose nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga ai. Në rast pengesash, si sëmundje, aksidente, udhëtime etj, administratori do të autorizojë një person tjetër për përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë.



**KREU IV**  
**Viti Financiar-Audituesit**

**NENI 13**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Administratori merr masa mbi hartimin e pasqyrave financiare të formuluar konform ligjit mbi kontabilitetin.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

**NENI 14**  
**Audituesit**

Audituesi Ligjor ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit Audituesi Ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

**NENI 15**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;





e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 16**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **NENI 17**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejnë dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, pjesa e parë mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

#### **NENI 18**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKUI VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**REFAB Construction Shpk**

**Festim Tröci**

